



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
SHËRBIMI SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR I KOSOVËS -
UNIVERSITETSKA BOLNIČKA I KLINIČKA SLUŽBA KOSOVA -
THE HOSPITAL AND UNIVERSITY CLINICAL SERVICE OF KOSOVO
ARKIVI QENDROR - CENTRALNI ARHIV - CENTRAL ARCHIVE

Nr. pjesis org. _____
org. jed. _____
org. unit _____
Nr. i faq. _____
Br. str. _____
No. delc. _____

Nr. Prot. 7715
Broj. prot. _____
Prot. no. _____
Data 30.11.21
Datum _____
Date _____

PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës-(SHSKUK)

Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-(UBKSK)

Hospital and University Clinical Service of Kosovo-(HUCSK)

Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Univerzitetski Klinički Centar Kosova –

University Clinical Center of Kosovo

Sektori i Personelit



Ref. Nr. 704/21

Datë 24.11.2021

Prishtinë

Komisioni i Ankesave i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës në përbërje nga Dr. Nazmi Kolgeci, Kryetar, Lumnie Statovci dhe Suzana Bunjaku anëtarë, në procedurën e ankesave lidhur me konkursin nr. 5491 datë 12.08.2021 pika 7 (Teknikt të radiologjisë) në QKUK, në bazë të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrat e Publikë, neni 74 paragrafët 1 dhe 2 dhe dispozitave ligjore në fuqi, pas mbajtjes së Seancës së shqyrtimit të ankesës më 24.11.2021, lëshon këtë:

V E N D I M

- I. **Pozita e shtatë (7) për Teknikë/e të RTG-Bachelor** sipas Konkursit publik nr. 5491 të datës 12.08.2021, bashkë me Testin me shkrim të publikuar me nr. 6858/3 datë 20.10.2021 dhe vendimin përfundimtar për publikim të rezultateve nr. 6900/6 të datës 27.10.2021 **anulohet në tërësi.**
- II. Ky Vendim hyn në fuqi më 24.11.2021.

A r s y e t i m

Gjatë procedurës së shqyrtimit të shumë ankesave të kandidatëve për pozitën Teknikë/e të RTG-Bachelor në QKUK, në konkursin e shpallur Nr. 5491 datë 12.08.2021, në njoftimin 30 ditor, ndërsa dokumentet janë pranuar në afatin 8 ditor, Komisioni i Ankesave e **ANULON** në tërësi pikën e shtatë e konkursit nr. **Nr. 5491 datë 12.08.2021** për teknikë/e të RTG - Bachelor. Arsytet janë: Komisioni vlerëson se ka pasur shumë ankesa dhe pakënaqësi për shkak të pyetjeve jo të formuluar mirë dhe parregullsive gjatë mbajtjes së testit me shkrim (siç kanë cekur kandidatët edhe në ankesa), vendosëm që pozita e shtatë (7) për Teknikë/e të RTG-Bachelor sipas Konkursit publik nr. 5491 të datës 12.08.2021, bashkë me Testin me shkrim të publikuar me nr. 6858/3 datë 20.10.2021 dhe vendimin përfundimtar për publikim të rezultateve nr. 6900/6 të datës 27.10.2021 të anulohet në tërësi dhe i rekomandojmë Sektorit të Personelit që kjo pozitë të rishpallet konform bazës ligjore sa më shpejtë që të jetë e mundur. Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur, ka të drejtë të ushtroi ankesë në Gjykatën kompetente, në afat brenda 15 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

VENDIMI T'I DORËZOHET:

- Të përmendurit-res,
- Komisionit të Ankesave dhe
- Arkivit.

KRYETARI

Dr. Nazmi Kolgeci